

FJALA E DEPUTETES ANDIA ULLIRI

E MARTË 1 NËNTOR 2022

Sot fokusin do ta kem më shumë tek arsimi i lartë, pasi mendoj se duhet të kemi një qasje më proaktive me studentët. Duke qenë se kam qenë vetë studente, e ndiej ndonjëherë edhe shpërfilljen nga politikat, që jo gjithmonë janë mbështetëse. Së pari, do ta nisja me disa pyetje për akomodimet e studentëve. Nga “Pakti për universitetin”, në premtimet që u bënë duhet të kishim të paktën 2 kampuse të reja, përkatësisht konvikte në Tiranë dhe në Durrës. Duke qenë se edhe rektori i Universitetit të Tiranës kërkoi sërish jetësimin e projektit të kampusit universitar të Tiranës, dua të di se çfarë mbështetjeje do të japë Ministria e Arsimit dhe Sportit për këto 2 projekte, pra për kampusin e Tiranës dhe, po ashtu, për konviktet në Durrës, që duhet të ishin dorëzuar prej disa viteve, projektet e të cilave duhet të kishin përfunduar që në vitin 2019, ndërkohë që sot janë ende në proces.

Së dyti, shqetësimi që më vjen nga studentët është fakti se tarifat studimore janë shumë të larta. Cila është qasja juaj dhe mbështetja që ju do të jepni në aspektin e uljes së tarifave, përveç bursave që ju paracaktuar? Gjithashtu, një shqetësim tjetër është edhe për tarifat e larta të konvikteve. Ju thatë se do të ketë një mbështetje prej 250 milionë lekësh për akomodim, por shqetësimi që vjen nga studentët është se jo të gjithë jetojnë në konvikte. Ata zgjedhin të mos jenë pjesë e këtyre konvikteve universitare, për shkak se shumica e këtyre konvikteve janë të rrënuara, nuk i kanë shërbimet apo kushtet standarde, prandaj jetojnë në shtëpi me qira, duke mos pasur mundësi ta përfitojnë këtë fond që ju keni përcaktuar në mbështetje të akomodimit. Po ashtu, a ka ndonjë projekt Ministria e Arsimit dhe Sportit në lidhje me kartat e studentit? Kam parë që ka një ndryshim në qasje për kartat e studentit, por kjo është nga niveli vendor.

Shqetësimi im është nëse Ministria e Arsimit e ka në programin e saj mbështetjen për studentët nëpërmjet kartës së studentit, si projekt qeveritar, pra mbështetje nga pushteti qendror, jo nga ai vendor, pasi duhet të ketë një impakt më të madh. Ju keni parashtruar disa herë se do të ketë investime në biblioteka dhe, lidhur me këtë, doja të dija se sa do të jetë ky investim konkretisht dhe nëse ju keni bërë një shpërndarje gjeografike të këtyre bibliotekave në Shqipëri. Pra, a ka ndonjë qytet apo bashki që është parë më me prioritet për të pasur bibliotekë? Gjithashtu, kur flasim për bibliotekat, ndoshta flasim në aspektin e projekteve prestigjioze të një biblioteke, e cila do të shërbejë si qendër studimesh ose

nëse do të jetë në qytete ku ka universitete, pra aty ku studentët kanë vërtet nevojë për biblioteka universitare. Po ashtu, dua të mbështes edhe zonjën Aça kur tha se ne kemi probleme në infrastrukturë dhe, kryesisht, për terrene sportive.

A keni një shpërndarje gjeografike për shpërndarjen e fondeve që keni? Pra, ky fond është i paracaktuar ku do të shkojë, nëse do të ketë ndërtime të terreneve sportive? Për pjesën më të madhe të pyetjeve që kisha, mora përgjigje kur ju raportuat për buxhetin dhe sot dua të fokusohem vetëm te buxheti. Në mbyllje, dua të theksoj se edhe samiti global tregoi se arsimi është në rrezik. E di që edhe ju ishit pjesë e këtij samiti. Unë mendoj se vitin 2023 sot ne duhet ta shohim me tjetër perspektivë, duke parë emigracionin masiv dhe atë që po ndodh në qytetet tona. Po shohim se studentët nuk po trajtohen me interesin e duhur nga kjo qeveri. Ne duhet t'u japim atyre mundësinë që të zhvillohen në vendin e tyre, duke iu ofruar pasjen e infrastrukturës, pra ata duhet të kenë standarde, duhet të kenë universitete, biblioteka universitare, terrene sportive dhe aktivitete ku të angazhohen.

Duke marrë shkak nga pronocimi i ministres së Kulturës kur tha se, në kuadër të "Paktit për universitetin" dhe të ndërkombëtarizimit, në universitetin e Gjirokastrës do të ofronte një program masteri për trashëgiminë kulturore, si mund të ndikojë ky program në buxhet, në mbështetje të studentëve që do të shkojnë nga Tirana, për shembull, në Gjirokastrë? Pra, cila është mbështetja e qeverisë ose promovimi i këtyre programeve të studimit për studentët? Kam edhe një pyetje, për të cilën nuk kam marrë përgjigje as herën e kaluar. Me sa pashë, urdhri nr.542 i datës 15.9.2022 tregon se ju i keni përcaktuar shkollat që do të përfitojnë nga oficerët e sigurisë. Cili është kriteri në përzgjedhjen e këtyre shkollave? Nëse mundeni, të ma jepnit sot përgjigjen, pasi janë disa shkolla që më interesojnë!
Faleminderit!